Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo

ASHNA

Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror
Agencija za Vazdušno Navigacijske Usluge
Air Navigation Services Agency

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS
MINISTARSTVO ZHIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE
MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE
Njësia org. / Org.Jedinica / Org.Unit: 04
Nr. i Prot. / Broj Prot. / Prot. No.: 9168
Nr. i Faqeve / Br. Stranica / No.Pages: 03
Data / Datum / Date: 30.11.23
PRISHTINË / A No.2

# Plani i Performancës 2024

Plani i Performancës së ASHNA-së hartohet në mbështetje të Ligjit NR. 06/l-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura dhe të Rregullores NR. 12/2023 Mbi Sistemin e Menaxhimit të Performancës për Agjencitë në Kuadër të Administratës Shtetërore të Republikës së Kosovës.

Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror (ASHNA) është organizatë buxhetore e themeluar si agjenci e pavarur me Ligjin Nr. 04/L-250 për Agjencinë e Shërbimit të Navigacionit Ajror.

ASHNA ofron shërbimet e navigacionit ajror prej nivelit "GND" (tokë) deri në "FL 205" (6250m), për të gjitha kategoritë e trafikut civil dhe ushtarak në Republikën e Kosovës.

Në kuadër të autorizimeve të garantuara me legjislacionin përkatës në Republikën e Kosovës, ASHNA përmes këtij plani synon të organizoj, përmbush dhe paraqes në mënyrë te drejtë dhe efektive, objektivat e saj për vitin 2024.

Siguria është mision dhe qëllim kryesor i ASHNA-së. Sistemi i menaxhimit të sigurisë mbetet mekanizmi kryesor për ruajtjen, monitorimin dhe ngritjen e sigurisë.

Duke pasë parasysh specifikat e organizimit dhe menaxhimit të hapësirës ajrore të Kosovës, që për arsye të njohura kufizojnë shtrirjen e plotë në ofrimin e shërbimeve të navigacionit ajror në hapësirën ajrore të Kosovës, ASHNA krahas sigurisë, ka vendosur si mision edhe normalizimin e plotë të hapësirës ajrore.

Ky mision, synohet të arrihet në kuadër të mandatit të agjencisë, duke plotësuar kërkesat rregullative dhe teknike, në koordinim të mirëfilltë me autoritetet përkatëse vendore dhe ndërkombëtare.

| **Data:** | | 31 Tetor 23 | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **AGJENCIA** | | Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror | | | | | |
| **MINISTRIA PËRGJEGJËSE** | | Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës | | | | | |
| ***Misioni i Agjencisë*** | | ***Ofrimi i sigurtë i shërbimeve të navigacionit ajror dhe normalizimi i hapësirës ajrore të Republikës së Kosovës*** | | | | | |
| **Objektivat** | **Treguesi(t)** | **Vlera bazë** | **Vlera e synuar** | **Rezultatet (Outputet)** | **Aktivitetet kryesore** | **Alokimi financiar** | **Referenca në dokumente strategjike/politike** |
| **Normalizimi i hapësirës (ulët) ajrore** | Hapja e rrugëve ajrore me Malin e Zi për trafik komercial | 0.50 % | 0.75 % | 1. Shkurtim i rrugëtimit për/nga Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës « Adem Jashari «<br><br>2. Zvogëlimi i emetimit të CO2 | 1. Lidhja e Letër Marrëveshjeve (LoA) me shtetet fqinje, përkatësisht me Malin e Zi<br><br>2. Koordinimi me institucionet relevante vendore dhe ndërkombëtare<br><br>3. Funksionalizimi i linjave të komunikimit<br><br>4.Publikimet/njoftimet përkatëse aeronautike për hapjen e rrugëve ajrore | 48.000 | PKZH |
| **Përmirësimi dhe modernizimi i sistemeve të navigacionit ajror** | 1. Implementimi i projektit Menaxhimi i Trafikut Ajor (ATM) 2024<br><br>2. Përmirësimi (upgrade) i radarit të Goleshit i përfunduar<br><br>3. "Marrëveshja e Nivelit të Shërbimit" (SLA) të nënshkruara | 20 %<br><br>0.0 %<br><br>0.0 % | 60 %<br><br>100 %<br><br>100 % | 1. Nuk kemi ndonjë rezultat të prekshëm në këtë fazë të projektit<br><br>2. Përmirësimi i shërbimeve të vrojtimit/ kontrollit radarik<br><br>3. Mirëmbajtje e vazhdueshme dhe intervenime të menjëhershme të nivelit III në sistemet dhe | 1. Ri-konstruktimi i sallës operative për Njësinë Vajtje-Ardhje (APP) dhe Njësinë e Kontrollit të Hapësirës së Lartë Ajrore (ACC)<br><br>1.1 Furnizimi dhe instalimi i konzolave operative (ATM)<br><br>1.2 Trajnimi i kontrollëve të trafikut ajror për Vrojtim/ Kontrollë i Hapësirës Ajrore (Area Control Survelliance-ACS)<br><br>2. Zhvillimi i procedurave të | **1,999,999**<br><br>**1,200,000**<br><br>**386.000** | PKZH |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | paisjet përkatëse. | prokurimit për përmirësim (upgrade) të radarit të Goleshit.<br><br>2.1 Nënshkrimi i kontratës<br><br>2.2 Implementimi i kontratës<br><br>3. Zhvillimi i procedurave të prokurimit për "Marrëveshja e Nivelit të Shërbimit" (SLA)<br><br>3.1 Nënshkrimi i kontratave<br><br>3.2 Implementimi i i kontratave"Marrëveshja e Nivelit të Shërbimit" (SLA) | | |
| **Shfrytëzimi i burimeve natyrore të energjisë** | Instalimi dhe përdorimi i paneleve solare i përfunduar | 0.0 % | 25 % | 1. Ulje e ndotjes<br><br>2. Ulje e shpenzimeve të energjisë elektrike | 1. Zhvillimi i procedurave të prokurimit | **360.000** | Strategjia e Energjisë 2022-2031 |
| **Ngritja e kapaciteteve njerëzore** | Përfundimi i shkollimit të kandidatëve për student kontrollorë të trafikut ajror | 33<br><br>(aktuali sht 33 Kontrol lorë të Trafikut Ajror) | 45<br><br>(synim 45 Kontrol lorë të Trafikut Ajror) | Numër i mjaftueshem i Kontrollorëve të Trafikut Ajror | 1. Rekrutimi i 12 Kandidatëve për Studentë Kontrollorë të Trafikut Ajror<br><br>2. Shkollimi 12 Kandidatëve për Studentë Kontrollorë të Trafikut Ajror | **450.000** | PKZH |

Drejtori i Agjencisë

Njësia Përgjegjëse